

Bazuar në Nenin 13, alinea 4. paragrafi 14, 53,54,e në lidhje me Nenin 329 të Ligjit për Shoqëri Ekonomike (Fleta Zyrtare e Malit të Zi nr. 65/20) Neni 38 paragrafi 1 pika 14 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Fleta Zyrtare e Malit të Zi nr. 2/18,34/19 dhe 38/20) dhe Nenit 58 alinea 1 pika 14 e Statutit të Komunës së Ulqinit (Fleta Zyrtare e Malit të Zi nr. 48/19, Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në seancën e mbajtur më 13.10.2022 ka miratuar

## **VENDIMIN**

### **për ndryshimet e Vendimit për krijimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar Për ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit, kultivimin dhe gjuetinë e egërsirave dhe peshkim. "Ulqin"**

#### **Neni 1**

Sh.p.k Për ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit, kultivimin dhe gjuetinë e egërsirave dhe peshkim "Ulqin" është themeluar me vendimin për themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Fleta Zyrtare – Rregullorja e Komunës", nr. 4/2019

#### **Neni 2**

Neni 12 i Vendimit ndryshohet si vijon:

##### **Bordi i Drejtorëve:**

- menaxhon Shoqërinë dhe i jep udhëzime drejtorit ekzekutiv lidhur me menaxhimin e punëve të shoqërisë;
- përcakton propozimin e akteve të përgjithshme të miratuara nga themeluesi
- miraton Statutin e Shoqërisë, me pëlqimin e themeluesit;
- miraton akte të tjera të Shoqërisë në përputhje me ligjin;
- propozon miratimin e vendimit për ndryshimin e statusit;
- emëron dhe shkarkon persona me detyra të veçanta;
- përcakton propozimin e programit vjetor të veprimtarive;
- përcakton draftin e Raportit Vjetor për punën dhe veprimtarinë financiare të shoqërisë;
- propozimet për vendime për shpërndarjen e perfitimeve dhe mënyrën e mbulimit të humbjeve;
- propozon marrjen e vendimit për rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit themelor të shoqërisë dhe për ndryshimin e veprimtarisë dhe të vendndodhjes së shoqërisë;
- përcakton propozimet për vendime për ndryshimin e formës, ristrukturimin;
- sjell çmimet e shërbimeve;
- merr vendim për organizimin e brendshëm të shoqërisë dhe akt për sistemim;
- përcakton politikat e kontabilitetit të shoqërisë dhe politikat e menaxhimit të rrezikut;
- miraton planin e prokurimit publik
- zbaton vendimet e themeluesit;
- propozon politikën e shpërblimeve për punonjësit e organit drejtues;
- miraton raportet tremujore të drejtorit ekzekutiv për veprimtarinë e shoqërisë;
- miraton plane dhe programe nga fusha për të cilën është themeluar shoqëria;
- miraton pasqyrat financiare të shoqërisë
- kryen punë të tjera në përputhje me ligjin, vendimin për themelimin dhe statutin.

#### **Neni 3**

Neni 13 i Vendimit ndryshohet si vijon:

Bordi i Drejtorëve emërohet nga themeluesi i Shoqërisë.

Bordi i Drejtorëve ka 3 (tre) anëtarë.

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë.

Kryetari dhe anëterët i Bordit të Drejtorëve emërohen nga Themeluesi për një periudhë katërvjeçare ose nëse themeluesi vendos ndryshe, me mundësi riemërimi.

Bordi i Drejtorëve merr vendime të vlefshme nëse në mbledhje është e pranishme shumica e anëtarëve të bordit.

#### **Neni 4**

Pas Nenit 14, shtohet një Nen i ri 14a, i cili thotë:

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve kryejnë funksionet e tyre me një tarifë mujore të përcaktuar nga Themeluesi.

#### **Neni 5**

Neni 19 ndryshohet si vijon:

Personi i autorizuar përfaqësim të shoqërisë është Drejtori Ekzekutiv.

#### **Neni 6**

Neni 21 ndryshohet si vijon:

Kompania është e obliguar t'i përshtasë aktet dhe veprimet e saj në pajtim me këtë vendim, më së voni brenda gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

#### **Neni 7**

Ky Vendim për ndryshimet hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Fletën Zyrtare të Malit të Zi - Rregullorja e Komunës".

### **KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT**

**Numri: 02-016/22-392-3**

**Ulqin, 13.10.2022**

**KRYETARI,  
Ardijan Mavriq,d.v.**